



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Adresa: Rruga "Abdi Toptani" (ish Hotel Drini) Tiranë,

Tel/Fax 04 22268141 ; 04 22268142

Nr. 660/6 Prot.

Tiranë, më 07.03.2017

V E N D I M
Nr. 46, datë 07.03.2017

***“Mbi përfundimin e procedimit administrativ,
filluar me urdhrin e verifikimit nr. 660/1 prot, datë 25.11.2016”***

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, si dhe Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit, pas shqyrtimit të relacionit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me procedurën e ecurisë disiplinore, të filluar nga eprori direkt ndaj punonjësit ***** , në institucionin e Avokatit të Popullit,

VËREJ SE,

Me Urdhrin nr. 660/1 prot, datë 25.11.2016, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka nisur verifikimi i ligjshmërisë së procedurës së ecurisë disiplinore, të filluar nga eprori direkt, ndaj punonjësit ***** , në institucionin e Avokatit të Popullit.

Në zbatim të urdhrin të mësipërm, nëpërmjet shkresës nr. 660/2, datë 10.06.2016, “Njoftim mbi fillimin e verifikimit”, është vënë në dijeni institucioni i Avokatit të Popullit për këtë proces, duke i kërkuar edhe dokumentacionin e nevojshëm për realizimin e tij.

Pasi është administruar e gjithë praktika shkresore, e cila ishte bashkëlidhur informacionit të përcjellë nëpërmjet kërkesave me nr. 660 prot., datë 14.11.2015 dhe nr. 660/5 prot., datë 27.12.2016, të paraqitur nga kërkuesi ***** dhe praktika dokumentare, e bashkëlidhur informacionit me nr. 660/4, datë 05.12.2016, të marrë nga institucioni i Avokatit të Popullit, rezulton se:

Punonjësi ***** , pas kryerjes së procedurës së konkurrimit, është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin e punës, “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë,

Integritet Evropian dhe Koordinimit të Projekteve”, në institucionin e Avokatit të Popullit, me urdhrin nr. 69 prot., datë 27.04.2015, të Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit.

Mosmarrëveshja që është objekt i këtij hetimi administrativ, ka filluar nga eprori direkt, Drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve ndaj Qytetarëve, i cili në përfundim të periudhës së provës, me aktin nr. 159, datë 10.06.2016, ka marrë vendimin për të shtyrë 6 muaj, periudhën e provës për këtë punonjës, duke arsyetuar se kishte nevojë për më shumë kohë për të vlerësuar punonjësën në fjalë, duke parashtruar edhe arsyet që kanë sjellë pamundësinë e vlerësimit të punës, gjatë periudhës një vjeçare.

Ndër shkaqet e renditura, për marrjen e këtij vendimi, përmendet fakti se për një pjesë të konsiderueshme të periudhës së provës, nëpunësi kishte qenë në një trajnim në Institucionin e Mediatorit të Francës, në Paris dhe nuk kishte kryer direkt detyrën në të cilën ishte emëruar. Gjatë periudhës një vjeçare, për shkaqe të vlerësuar nga titullari, ai ka mbajtur më shumë kontakte dhe ka relatuar punën e tij tek Kabineti i këtij institucioni, duke shfaqur një komunikim jo të mirë me eprorin e tij dhe ka bërë mungesa të shumta, pa arsye, në punë.

Ky vendim i është komunikuar nëpunësit të interesuar, me shkresën me nr. 159/1, datë 10.08.2016, *“Njoftim për zgjatjen e periudhës së provës për konfirmimin e statusit të nëpunësit civil”*, i cili duke mos qenë dakord me këtë akt administrativ, nëpërmjet memos nr. 159/2, datë 16.08.2016, *“Kundërshtim për paligjshmëri të aktit nr. 159/1 prot., datë 10.08.2016 dhe aktit nr.159 prot., datë 10.06.2016”*, ka ushtruar të drejtën e tij të ankimit ndaj vendimit të eprorit direkt, tek nëpunësi më i lartë civil i institucionit.

Me aktin nr. 159/3, datë 22.08.2016, *“Kthim përgjigje në lidhje me kërkesën për kundërshtimin e aktit administrativ, për shtyrjen e periudhës së provës”*, Sekretari i Përgjithshëm i institucionit, e ka njoftuar punonjësën në fjalë, se ankesa e tij nuk është vlerësuar e bazuar në ligj dhe në prova. Në përmbajtjen e kësaj shkrese, theksohet edhe roli i eprorit direkt në procesin e vlerësimit të rezultateve të periudhës së provës, si nëpunësi që ka tagrin e plotë, në bazë të ligjit, që të mbikëqyrë në mënyrë të drejtpërdrejtë, në linjën e hierarkisë organizative, nëpunësin që do të vlerësohet/konfirmohet.

Më tej konstatohet se, eprori direkt, me aktin nr. 159/6, datë 08.11.2016, *“Njoftim për fillimin e ecurisë disiplinore”*, ka vendosur të fillojë ecurinë disiplinore ndaj punonjësit ******, duke evidentuar si motivacion, mosrespektimin në mënyrë të përsëritur të orarit zyrtar nga ana e tij dhe mungesa pa arsye në punë, të cilat janë të evidentuara edhe nëpërmjet ndalesave nga paga, për ditët e munguara dhe të pajustificuara.

Për këto mungesa pa arsye, eprori direkt në disa raste, me qëllim këshillimin për përmirësimin e gjendjes, i ka tërhequr vëmendjen punonjësit në fjalë, por ky i fundit nuk e ka vlerësuar dhe mirëkuptuar këtë veprim, duke vazhduar me mungesën e komunikimit dhe fleksibilitetit në marrëdhënie me eprorin e tij. Vërtetohet se eprori direkt, si dhe struktura të tjera eprore të institucionit, e kanë informuar në vazhdimësi punonjësën ******, në lidhje me problematikat dhe pasojat që mund të vijnë nga mosrespektimi i vazhdueshëm i disiplinës në punë dhe shkelja e rregullave të etikës.

Në këto rrethana, duke analizuar aktet e administruara gjatë hetimit administrativ, rezulton se, veprimet e konstatuara më sipër, vijnë në kundërshtim me Rregulloren e miratuar me Urdhrin nr. 94 prot., datë 05.05.2014, të Avokatit të Popullit, *“Mbi regjimin e hyrje-daljeve dhe lëvizjeve në ambientet e Institucionit të Avokatit të Popullit”*, ku përcaktohen në mënyrë të shprehur procedurat, që duhet të ndiqen nga punonjësit gjatë lëvizjes në orarin e punës.

Fillimi i ecurisë disiplinore në këtë rast, mbështetet në nenin 57, pika 1, c dhe pika 4, a dhe c, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe pikës 19, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, pasi aplikimi i masës disiplinore *“vërejtje”*, është në kompetencë të eprorit direkt. Nga ana e këtij të fundit, është treguar kujdes që nëpunësit në fjalë t'i krijohet mundësia për të mbrojtur të drejtat e tij, përfshirë këtu paraqitjen e pretendimeve në formë shkresore, si dhe zhvillimin e një seance dëgjimore me eprorin direkt, në ditën dhe orën e përcaktuar për këtë qëllim.

Pasi ka marrë njoftimin për fillimin e ecurisë disiplinore, nëpunësi ***** ka reaguuar menjëherë, duke ushtruar të drejtën e tij të ankimit, nëpërmjet memos së datës 11.11.2016, drejtuar Avokatit të Popullit dhe Sekretarit të Përgjithshëm të institucionit.

Rezulton se, seanca dëgjimore për zhvillimin e kësaj ecurie disiplinore, është zhvilluar ditën e caktuar në aktin e njoftimit të fillimit të ecurisë disiplinore, në prani të Sekretarit të Përgjithshëm, eprorit direkt, Drejtorit të Financës dhe Burimeve Njerëzore, Përgjegjës të Sektorit të Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit dhe Koordinimit të Projekteve dhe Sekretares, të ngarkuar me mbajtjen e procesverbalit të takimit.

Gjatë zhvillimit të këtij takimi, nëpunësit të proceduar i është krijuar mundësia për paraqitjen e argumenteve dhe shkaqeve mbi bazën e të cilave mund të kundërshtohet ecuria disiplinore (*ç`ka provohet me proces-verbalin nr. 159/8 prot., datë 14.11.2016, i cili nuk është nënshkruar nga ankuesi, duke mos paraqitur asnjë arsye ligjore për këtë veprim*). Në mungesë të parashtrimit të fakteve bindëse, pas shqyrtimit të pretendimeve të tij të paraqitura me shkrim, lidhur me mungesat e pajustificuara, nga ana e eprorit direkt, bazuar në nenin 57, pika 1/c dhe pika 4/a, dhe c, të nenit 58, pika a, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe pikës 19, të Vendimit të Këshillit të Ministrave, nr. 115, datë 05.03.2014, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*, është arritur në përfundimin për përmbylljen e procesit administrativ me marrjen e masës disiplinore *“Vërejtje”*.

Nga gjithë sa u përshkrua më sipër, arrihet në konkluzionin se, procedura e ndjekur nga eprori direkt për fillimin, zhvillimin dhe përfundimin e kësaj ecurie disiplinore, për punonjësin *****, në pozicionin e punës, *“Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Jashtë, Integritit Evropian dhe Koordinimit të Projekteve”*, në institucionin e Avokatit të Popullit, është kryer në përputhje me ligjin nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe Vendimin nr. 115, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për përcaktimin e procedurës disiplinore dhe të rregullave për krijimin, përbërjen e vendimmarrjen në komisionin disiplinor në shërbimin civil”*.

Gjithashtu, vlerësohet se me të drejtë, është arritur në përfundimin se argumentat e paraqitura për mbështetjen e ecurisë disiplinore kanë qenë të mjaftueshme për të përmbyllur procesin administrativ me aplikimin e masës disiplinore “vërejtje”.

Në këto kushte, në bazë të nenit 34, të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vend për përfundimin e procedimit administrativ.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në nenin 90, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe nenin 34 të Rregullores “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

VENDOSA:

1. Përfundimin e procedimit administrativ të filluar me Urdhrin nr. 660/1 prot, datë 25.11.2016, “Për verifikimin e informacionit të ardhur nga punonjësi *****”, në lidhje me procedurën e ecurisë disiplinore të filluar nga eprori direkt”.
2. Të njoftohen për këtë vendim, institucioni i Avokatit të Popullit si dhe kërkuesi, *****.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA